

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 320, Datë 12.12.2025

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “GREEN ENERGY” SH.P.K. PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E ASETEVE FIKSE TË SAJ SI MJET
PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të neneve 16, 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, gërma “b” të Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2934/2 prot., datë 04.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN ENERGY” sh.p.k. për dhëniën e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve fikse të saj si mejt për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se,

- Shoqëria “GREEN ENERGY” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 121, datë 09.06.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet 2 MW, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Me shkresat nr. 2934 prot., datë 26.11.2025 dhe nr. 2934/1 prot., datë 27.11.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE, për vendosjen e aseteve të saj si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj Banka Amerikane e Investimeve sha.
- Në kuadër të kësaj kërkesë dhe në mbështetje të dispozitave të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit, shoqëria ka depozituar kontratat e kredive, si dhe informacion mbi vlerën e aseteve të projektit, nga e cila rezulton se vlera e tyre është më e vogël se 150.000.000 Lekë.
- Në nenin 44, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, përcaktohet se, *Miratimi i ERE-s nuk është i nevojshëm në rastet e transferimit të aseteve me vlerë minimale, apo aseteve që nuk lidhen ngushtësisht me veprimtarinë e licencuar, sipas rregullores të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni*, sikurse cituar dhe më sipër në këtë relacion, ky parashikim ligjor është konkretizuar në nenin 4, gërma “b”, të Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit, ku përcaktohet se, *për transferimin e aseteve të të*

licencuarve me kapacitet te instaluar nën 1 MW, nuk ka nevojë për miratimin e ERE. Për të gjithë të licencuarit e tjerë do të kërkohet miratimi i ERE-s për transferim të aseteve kur vlera e asetit që kërkohet të transferohet është më e madhe se 150.000.000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë.

- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet se ERE nuk mund të marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “GREEN ENERGY” sh.p.k., për sa kohë nuk plotësohet sa kërkuar në nenin 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 dhe nenin 4, gërma “b” të Rregullores me nr. 119/2016.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “GREEN ENERGY” sh.p.k. për dhënien e autorizimi nga ERE për vendosjen e aseteve fikse të shoqërisë, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj Banka Amerikane e Investimeve sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “GREEN ENERGY” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI